

Projekti i Menaxhimit të Burimeve Ujore

Projekti i Menaxhimit të Burimeve Ujore ka filluar në Nëntor të vitit 2004 dhe ka punuar për të realizuar objektivat dhe komponentet e përcaktuara në dokumentin për vlerësimin e projektit (PAD) dhe planin për implementimin e tij (PIP) të prillit 2004 dhe Marrëveshjen e kredise të Korrikut 2004 (kredia nr 39140-ALB). Bashkefinancues në projekt janë Kuwait Fund, OPEC, Granti Italian dhe Qeveria Shqiptare.

Krahas mbështetjes dhe suportit për Shoqatat e përdoruesve të Ujit (SHPU/FSHPU) ekzistuese, ky projekt kishte për qëllim të shtrihej në të gjithë rrethet e tjera dhe kryesisht në ato të zonës juglindore, veriore dhe verilindore të vendit.

Objektivat dhe komponentet kryesore të projektit.

Projekti Menaxhimit të Burimeve Ujore ka punuar për të realizuar objektivat dhe komponentet e përcaktuara në dokumentin për vlerësimin e projektit (PAD) dhe planin për zbatimin e tij si dhe detyrat e lëna nga misionet e supervizionit në Aide-Memoire.

Objektivat e projektit sipas PAD:

1. Rritja e prodhimit bujqësor nëpërmjet përmirësimit të shërbimit të ujitjes.
2. Rritja e aftësisë financiare të skemave ujëtare dhe kulluese.
3. Pakesimi i rrezikut nga vërshimet dhe nga demtimet e digave.

Komponentet kryesore të projektit:

1. Rehabilitimi fizik në ujitje e kullim
2. Mbështetje institucionale për ujitjen, kullimin dhe menaxhimin e përmytjeve.
3. Mbështetje institucionale për menaxhimin e burimeve ujore
4. Mbështetje për PMU gjatë zbatimit të projektit